## QERSHOR 2024

| Nr. (1) | Data e regjistrimit të kërkesës (2) | Objekti (3) | Data e kthimit të përgjigjes (4) | Përgjigja(5) | Statusi i kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 | 3.06.2024 | 1. Sa është numri total i personave qe kane përfituar nga skemat e mbështetjes financiare nga Ministria juaj për ngritjen e biznesit te tyre gjate periudhës janar- dhjetor 2023'! Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj'! 2. Sa është numri i te rinjve (15-29 vjeç) qe kane qe kane përfituar nga skemat e mbështetjes financiare nga ministria juaj për ngritjen e biznesit te tyre gjate periudhës janar- dhjetor 2023'! Sa prej tyre janë | 10.06.2024 | Në vijim të e-mail-it tuaj ju bëjmë me dije se për vitin 2023 numri total i projekteve që kanë përfituar mbështetje financiare për projekte në fushën e turizmit , është 33, nga të cilat 14 janë femra dhe 19 meshkuj. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | femra dhe sa meshkuj? | | | | |
| 32 | 4.06.2024 | Prej vitit 2021, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED Washington DC), është angazhuar në zbatimin e projektit “Forcimi i transparencës dhe qeverisjes së mirë përmes konsultimit publik efektiv”. Kjo nismë, në fazën e saj të parë, ofroi asistencë teknike dhe trajnime mbi konsultimin publik për institucionet e administratës qendrore, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe | 14.06.2024 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i publikon ne faqen zyrtare te gjitha aktet për konsultim publik, ne linkun:https://turizmi.gov.al/konsultime/ gjeni aktet e publikuar se bashku me informacionin e kërkuar. | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kryeministrinë. Në fazën e dytë, projekti fokusohet në monitorimin e proceseve të konsultimit publik në nivelin e qeverisjes qendrore. Për këtë proces, IDM ka njoftuar zyrtarisht zyrën e Kryeministrit gjatë muajit shkurt, e cila është përfshirë gjithashtu në procesin e konsultimit të metodologjisë së monitorimit. Monitorimi i IDM-së do të mbulojë 50 akte të konsultuara nga institucione të ndryshme të qeverisjes qendrore. Për sa më sipër, kërkohen të dhënat si vijojnë nga institucioni juaj: 1. Studime, sondazhe, analiza të tjera të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndërmarra nga institucioni juaj në lidhje me vlerësimin e efektivitetit të metodave të konsultimit publik dhe pjesëmarrjes së aktorëve jo qeveritarë/institucionalë, gjatë vitit 2022 dhe 2023. Nëse ka të tilla, lutem vihen në dispozicion rezultatet/gjetjet e analizës; 2. Raporte monitorimi dhe vlerësimit të proceseve të konsultimet publike të mbajtura nga vetë institucioni juaj gjatë vitit 2022 dhe 2023. Nësë ka të tilla, vihet në dispozicion dokumenti përkatës me gjetjet dhe rekomandimet; 3. Plani vjetor i konsultimit publik për | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | vitin 2022; 4. Matrica e përjashtimit nga konsultimi publik për aktet për të cilat është përgjegjës KM për vitin 2022 dhe 2023; Të dhëna në nivel vjetor: numri total i aktorëve jo qeveritarë që kanë marrë pjesë në konsultimet e institucionit për vitin 2022; Numri i pjesëmarrësve kontribues për këtë vit; 6. Të dhëna në nivel vjetor: numri total i aktorëve jo qeveritarë që kanë marrë pjesë në konsultimet e institucionit për vitin 2023; Numri i pjesëmarrësve kontribues për këtë vit; 7. Të dhëna në nivel vjetor: numri total i aktorëve jo qeveritarë që kanë | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | marrë pjesë në hartimin e akteve të institucionit për vitin 2022; Numri i pjesëmarrësve kontribues për këtë vit; 8. Të dhëna në nivel vjetor: numri total i aktorëve jo qeveritarë që kanë marrë pjesë në hartimin e akteve të institucionit për vitin 2023; Numri i pjesëmarrësve kontribuues për këtë vit; 9. Numri total i komenteve të marra nga institucioni për vitin 2022, nr. i komenteve të pranuara plotësisht, nr. i komenteve të pranuara pjesërisht, numri i komenteve të refuzuara dhe nr. i komenteve të pa trajtuara/pa përgjigje; 10. Numri total i | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | komenteve të marra nga institucioni për vitin 2023, nr. i komenteve të pranuara plotësisht, nr. i komenteve të pranuara; 11. Matrica për aktet e përjashtuara nga konsultimit dhe argumentet përkatëse; Gjithashtu, për projekaktet e mëposhtme, kërkohet si vijon: 1. Për Projektligjin "Për zbatimin e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit": - Plani individual i konsultimit publik; - Relacioni shoqërues i projektvendimit; - Informacion për fazën e hartimit të aktit, konsultim paraprak të tij, përbërja e grupit të punës për hartimin e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | aktit dhe institucioni propozues, lista e aktorëve joqeveritarë që kanë marrë pjesë në hartim, e disagreguar sipas sektorëve/organizatave e që ata përfaqësojnë dhe numri total i tyre.<br>- Lista e pjesëmarrësve jo qeveritarë në procesin e konsultimit, e disagreguar sipas sektorëve/organzatave që ata përfaqësojnë, numri total i tyre. - Matrica e palëve të interesit për këtë akt; - Skeda e analizës së metodave të konsultimit për këtë akt; - Raporti RIA dhe ndikimi i konsultimit publik tek RiA.<br>2. Për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ligjin Nr. 93/2015,<br>2. Për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar: - Plani individual i konsultimit publik; - Raporti individual i konsultimit publik; - Kanalet publike të përdorura për njoftimin e konsultimit akti përveç RENJKP - Metodat e njoftimit dhe metodat e konsultimit të përdorura përveç RENJKP Informacion për fazën e hartimit të aktit; konsultim paraprak të tij; përbërja e grupit të punës - për hartimin e aktit dhe institucioni propozues; lista e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | aktorëve joqeveritarë që kanë marrë pjesë në hartim, e disagreguar sipas sektorëve/organizatave që ata përfaqësojnë; numri total i tyre. - Tabela e plotë e komenteve të mbledhura me të gjitha metodat e konsultimit që tregon aktorët komentues, pranimin e plotë, të pjesshëm, refuzimin, mos trajtimin. - Lista e pjesëmarrësve jo qeveritarë në procesin e konsultimit, e disagreguar sipas sektorëve/organzatave që ata përfaqësojnë, numri total i tyre. - Matrica e palëve të interesit për këtë akt - Skeda e analizës së metodave të konsultimit për këtë akt - Raporti RIA dhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndikimi i konsultimit publik tek RiA 3. Për Projektligjin “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”: - Plani individual i konsultimit publik; - Informacion për fazën e hartimit të aktit; konsultim paraprak të tij; përbërja e grupit të punës për hartimin e aktit dhe institucioni propozues; lista e aktorëve joqeveritarë që kanë marrë pjesë në hartim, e disagreguar sipas sektorëve/organizatave që ata përfaqësojnë; numri total i tyre. - Matrica e palëve të interesit për këtë akt - Skeda e analizës së metodave të konsultimit për këtë akt - Njoftimi | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shpjegues / dokumenti konsultativ; 4. Për Projektligjin "Për një ndryshim në ligjin nr.10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar: - Plani individual i konsultimit publik; - Relacioni shoqërues i projektaktit; - Kanalet publike të përdorura për njoftimin e konsultimit akti përveç RENJKP - Metodat e njoftimit dhe metodat e konsultimit të përdorura përveç RENJKP - Informacion për fazën e hartimit të aktit; konsultim paraprak të tij; përbërja e grupit të punës për hartimin e aktit dhe institucioni propozues; lista e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | aktorëve joqeveritarë që kanë marrë pjesë në hartim, e disagreguar sipas sektorëve/organizatave që ata përfaqësojnë; numri total i tyre. - Tabela e plotë e komenteve të mbledhura me të gjitha metodat e konsultimit që tregon aktorët komentues, pranimin e plotë, të pjesshëm, refuzimin, mos trajtimin. - Lista e pjesëmarrësve jo qeveritarë në procesin e konsultimit, e disagreguar sipas sektorëve/organzatave që ata përfaqësojnë, numri total i tyre.<br>- Matrica e palëve të interesit për këtë akt - Skeda e analizës së metodave të konsultimit për këtë akt - Raporti RIA dhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndikimi i konsultimit publik tek RiA 5. Për Projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.155, datë 7.12.2020 “Për ndryshimet klimatike”: - Plani individual i konsultimit publik; - Relacioni shoqërues i projektaktit; - Njoftimi shpjegues / dokumenti konsultativ; - Kanalet publike të përdorura për njoftimin e konsultimit akti përveç RENJKP - Metodat e njoftimit dhe metodat e konsultimit të përdorura përveç RENJKP - Informacion për fazën e hartimit të aktit; konsultim paraprak të tij; përbërja e grupit të punës - për hartimin e aktit dhe institucioni | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | propozues; lista e aktorëve joqeveritarë që kanë marrë pjesë në hartim, e disagreguar sipas sektorëve/organizatave që ata përfaqësojnë; numri total i tyre. - Tabela e plotë e komenteve të mbledhura me të gjitha metodat e konsultimit që tregon aktorët komentues, pranimin e plotë, të pjesshëm, refuzimin, mos trajtimin. - Lista e pjesëmarrësve jo qeveritarë në procesin e konsultimit, e disagreguar sipas sektorëve/organzatave që ata përfaqësojnë, numri total i tyre. - Matrica e palëve të interesit për këtë akt - Skeda e analizës së metodave të konsultimit për këtë | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | akt - Raporti RIA dhe ndikimi i konsultimit publik tek RiA | | | | |
| 33 | 18.06.202 | Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare | 19.06.2024 | Kthyer përgjigje me shkresë. | Përfunduar | 0 |
| 34 | 18.06.2024 | Kërkese për informacion ne lidhje me: kushtet dhe dokumentacionin që kërkohet për t'u pajisur me certifikatë si specialist për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor. | 26.06.2024 | Është miratuar ligji nr. 128/2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10440, datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis ", të ndryshuar.<br>Në zbatim të tij, ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të pikës 4, të nenit 24 të ligjit, i cili citon se "Rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit. Ministri lëshon certifikatën".<br>Pas miratimit të aktit nënligjor të mësipërm, i cili përcakton procedurën dhe kriteret për pajisjen me certifikatë të ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimit mjedisor, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të bëjë njoftimin në faqen zyrtare të saj për pjesëmarrjen e të gjithë personave të interesuar. | Përfunduar | 0 |
| 35 | 19.06.2024 | Kërkesë për informacion ne lidhje me:<br>1.A është dhënë nga Ministria e Mjedisit | | Në proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | leja përkatëse për ndërtimin e Termocentralit në fshatin SUK1 në Roskovec, kërkuar nga “ FIER THERMOELECTRIC ‘‘ SHA?<br>2.Nëse nuk ka ende një leje, në cilën fazë është shqyrtimi i kësaj kërkese?<br>3.A plotësohen të gjitha kriteret ligjore në mbrojtje të mjedisit për këtë projekt?<br>4.Banorët e zonës thonë se nuk janë konsultuar në asnjë rast për këtë projekt? A do të merret parasysh nga ju shkelja e ligjit për konsultimet me banorët?<br>5.Pse është i domosdoshëm një projekt i tillë? Duke pasur parasysh që bëhet fjalë për një zonë ku bujqësia është shumë e zhvilluar dhe jetike për komunitetin. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 36 | 20.06.2024 | Kërkese për informacion ne lidhje me:<br><br>1. Sa plazhe publike ka në Shqipëri?<br><br>2. Sa plazhe private ka në Shqipëri?<br><br>3. Cilat janë problematikat e evidentuara në plazhet publike dhe private?<br><br>4. Sa përqind të vijës bregdetare duhet të shfrytëzohet nga publiku dhe sa nga sektori privat?<br><br>5. Çfarë kriteresh duhet të plotësojë një plazh publik dhe një plazh privat?<br><br>6. Si bëhet përzgjedhja e zonës për të përcaktuar një plazh publik?<br><br>7. Sa metra linearë janë të dedikuar për plazhe publike? (Ju | | Në proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | lutem ofroni të dhënat në shifra dhe përqindje)<br><br>8. Çfarë kriteresh duhet të përmbushë një ofrues i shërbimeve të plazheve private për të ofruar këtë shërbim?<br><br>9. Si janë të përcaktuara tarifat për të shfrytëzuar një hapësirë private?<br><br>10. Sa ishte hapësira e plazheve publike në vitin 2023? | | | | |
| 37 | 24.06.2024 | Kërkesë për informacion ne lidhje me:,<br>Sipas identifikimeve të vend depozitimeve në raportin e mësipërm,<br>a) listën e vend depozitimeve të rehabilituara deri tani?<br>b) emrat, vendndodhja (adresa e plotë), koordinatat | | Në proces | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | gjeohapësinore për secilin vend depozitim të rehabilituar. | | | | |

**Shënim:**

Regjistri përditësohet çdo muaj.

(1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.

(2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.

(3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

***(****Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale")*

(5) Ndihmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6**)** Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.